



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 17. 03. 2009, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -203

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Ishin të ftuar:

Dr. Fadil Beka, dr. Shqiptar Demaçi, dr. Arben Morina, dr. Argeta Gecaj – Gashi, dr. Aurora Bakalli dhe Florije Asllanaj

Mbledhjen e mbikëqyrën: Besnik Gashi – (*Klan Kosova*), Ardita Uka (*Zëri*), Valbona Mazreku (*RTV-21*), Arta Zogaj (*Inciativa*), Vahide Morina (*Radio blu sky*), Drita Vitia (*Infopress*), Rrezarta Ahmeti (*KDI*) dhe Blerina Uka (*NDI*).

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, zyrtar i lartë dhe Visar Krasniqi zyrtar ligjor.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 10. 2. 2009 dhe të 25. 02. 2009,
2. Shqyrtimi i raportit të avokatit të popullit lidhur me diskriminimin e pohuar nga R. A e të tjerë,
3. Shqyrtimi i petitionit të ushtruar nga 125 magjistra të shkencave të mjekësisë dhe i petitionit nr. 03-1641/10-982 të H. G. nga Podujeva.
4. Të ndryshme.

Ismet Beqiri - Propozoi që Komisioni t'ia fillonte punës me shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës, ndërsa pikat e tjera të liheshin për mbledhjen e radhës.

Komisioni, sipas propozimit, e miratoi rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se ish-in plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1 Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 10. 2. 2009 dhe të 25. 02. 2009

Kryetari - Konstatoi se Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të 10. 2. 2009 dhe të 25. 02. 2009.

2 Shqyrtimi i peticionit të ushtruar nga 125 magjistra të shkencave mjekësore

Ismet Beqiri - Njoftoi për përmbajtjen e peticionit, në të cilin kërkohet t'u mundësohet vazhdimi i studimeve të doktoraturës sipas normave në fuqi në kohën e regjistrimit të studimeve pasuniversitare. Ceku se ndërprerja arbitrare nga ana e Senatit të Universitetit të Prishtinës do të ishte hedikep i madh për nënshkruarit e peticionit, prandaj e ftoi përfaqësuesin e peticionit ta merrte fjalën.

Shqiptar Demaçi – Komisionin dhe të pranishmit i njoftoi për kronologjinë e problematikës, me të cilën ballafaqohen nënshkruarit e peticionit. Shtoi se problemi i tyre ka nisur nga 6 tetori i vitit 2005, kur Senati i UP-së, me një vendim të brendshëm, i suprimoi vendimet e mëparshme për t'i dhënë temat e doktoraturës deri më 31 gusht 2005. Nënvizoi se kanë magjistruar 250 kandidatë të shkencave të mjekësisë dhe vetëm 136 prej tyre janë ftuar në konkursin e shpallur për vazhdimin e studimeve të doktoraturës. Veprimin e Senatit e cilësoi shkelje të të drejtave të njeriut dhe apeloj tek institucionet shtetërore ta korrigojnë këtë lëshim dhe kërkesat e tyre për studime pasuniversitare, në bazë të kriterëve të mëparshme, të procedohen, të merren temat e doktoraturës dhe t'u mundësohet 80 kandidatëve të zgjedhur legalisht në vitin 2005/06 t'i mbrojnë disertacionet. Njëherësh kërkoi të abrogohet ose të shpallet i pavlefshëm konkursi për tema të doktoraturës i shpallur në janar 2009.

Arben Morina - Theksoi se grupi prej 80 mjekëve, të pranuar për studime të doktoraturës, ende nuk ka filluar të merret me hulumtime shkencore. Kërkoi të vazhdojnë studimet ngase konkursi është i plotfuqishëm dhe shtyrja e tij me arsyetimin se do të fillohet me sistemin e ri të Kartës së Bolonjës, është e pakuptimtë.

Luan Jaha – Lidhur me konkursin i njoftoi të pranishmit se praktika e studimeve të doktoraturës është ndërprerë me arsyetimin se do të fillohet me sistemin e ri të Bolonjës. Për një veprim të tillë është marrë përkrahja nga dekani i Fakultetit të Mjekësisë dhe nga Këshilli Mësimor i Fakultetit të Mjekësisë. Pastaj diskutuan Florije Asllani dhe Angela Geci

Ibrahim Makolli – Theksoi se Kosova është shndërruar në një laborator të madh. Në vend se kërkesat të mbështeten nga institucionet, po ndodh e kundërta, po pengohen. Vuri në pah se Universiteti i Prishtinës është duke u udhëhequr nga një grup njerëzish me interesa të caktuara dhe se ka shkelje të Ligjit për arsimin e lartë, të Kushtetutës dhe të konventave ndërkombëtare. Konkludoi se jemi viktime të eksperimenteve që po bëhen me ne. I rekomandoi Komisionit të ftohen rektori Enver Hasani dhe Senati i Universitetit të japin sqarime për shkeljet që po bëhen në institucione.

Prof. dr. Nerxhivane Dauti – Peticionin e çmoi lart dhe shprehu keqardhje që u janë mohuar të drejtat këtyre magjistrave. Sipas saj janë cenuar dispozitat pozitive të ligjeve në fuqi. I mbështeti kërkesat e tyre dhe u pajtua me parafolësit që të ftohen ministrat, rektori dhe dekani i Fakultetit të Mjekësisë.

Drita Maliqi - Shprehu keqardhje për nënshkruarit e peticionit. E kritikoi dhe e fajësoi rektorin e universitetit Enver Hasani, që e cilësoi shkelës kryesor të të drejtave të

njeriut. Sipas saj Karta e Bolonjës, edhe pse Kosova nuk e ka nënshkruar, po e shkatërron arsimin tonë të lartë.

Sanije Alijaj – U pajtua me diskutimet e parafolësve. Veprimin e Rektoratit e vlerësoi të ngutshëm. Kërkoj nga Komisioni që në mbledhjen e radhës të ftohen organet kompetente që ta njoftojnë Komisionin hollësisht për këtë çështje. E mbështeti sistemin e Bolonjës, por kërkoj të zbatohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pa e dëmtuar askënd.

Naim Rustemi – Vuri në pah se në këtë rast kemi të bëjmë me shkeljen e rregullave të konkursit. I propozoi Komisionit që të ftohet përfaqësuesi i Senatit - organi më përgjegjës. Ua kujtoi se në kuadër të Ministrisë ekziston procedura e shqyrtimit të konkursit që i përket fushëveprimit të Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës.

Hajredin Hyseni - U pajtua me mendimet e parafolësit. Kërkoj që kjo çështje të shqyrtohet. Ishte i mendimit, nëse paraqitet nevoja, kjo çështje të shtrohet edhe në seancën plenare.

Vezira Emrush – Diskutoi dhe u angazhua për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv për këtë pikë, Komisioni nxori këtë

Përfundim

- 1 Komisioni mori vendim që më 24. 03. 2009 t'i ftojë në takim ministrin e Arsimit, ministrin e Shëndetësisë, dekanin e Fakultetit të Mjekësisë që të njoftohet hollësisht për shqetësimet e paraqitura në peticion.
- 2 Stafi për Mbështetje teknike, juridike i Komisionit ngarkohet t'i kryejë me kohë të gjitha veprimet për organizimin e këtij takimi.

Vërejtje : Pikat e tjera të rendit të ditës do të shqyrtohen në mbledhjet e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri